



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KORÇË  
QENDRA SPORTIVE KORÇË SH. A  
QENDRA RINORE KORÇË

NR. \_\_\_\_ PROT

DATË 21.08.2025

**RELACION**

**PËR**

**“MIRATIMIN E PLANIT LOKAL TË VEPRIMIT PËR RININË NË  
BASHKINË KORÇË 2025-2028”**

Bashkia Korçë, në Bashkëpunim me Qendrën për të Drejtat e Fëmijëve në Shqipëri, me mbështetjen e Agjencisë Kombëtare të Rinisë dhe Ministrisë të Shtetit për Fëmijët, ka hartuar Planin Lokal të Veprimit për Rininë për vitet 2025-2028.

Plani Lokal i Veprimit për Rininë, ka dalë si rezultat i konsulencës me të rinjtë, nxënësit, grupet rinore, dhe takime konsultuese me të rinjtë, grupimet rinore, organizatat dhe aktivistët që operojnë në mënyrë aktive në Bashkinë e Korçës.

Ky plan ka për qëllim nxitjen e të rinjve duke nxitur ndërmarrjen e veprimeve aktive, në jetën sociale politike ekonomike dhe vendimmarrëse.

Hartimi i këtij Plani ka identifikuar si prioritet punësimin dhe sipërmarrjen rinore, pjesëmarrjen dhe përfaqësimin rinor në politikë dhe vendimmarrje, arsimimi cilësor dhe gjithëpërfshirës, përfshirjen e të rinjve në çështjet sociale, shëndetësore dhe shërbimet publike, mbështetjen e organizatave dhe nismave rinore në qytetin e Korçës.

Miratimi i këtij plani synon identifikimin e problemeve, nevojave dhe prioriteteve të të rinjve të Korçës dhe ofrimin e zgjidhjeve të mundshme, nëpërmjet ofertimit të mënyrave, mekanizmave dhe mjeteve të caktuara për të adresuar dhe zgjidhur sa më mirë problematikat e tyre.

Sa më lart parashtruam, bazuar në nenin 9 pika 1.1, 24, 54, 64 të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, K.Pr. Administrative, Ligjit 75/2019 “Për Rininë”, Strategjinë Kombëtare të Rinisë 2022-2029, i propozojmë Këshillit të Bashkisë Korçë të miratojë Planin Lokal të Veprimit për Rininë në Bashkinë Korçë 2025-2028, sipas dokumentit bashkangjitur.

**Përgjegjës I Qendrës Rinore Korçë:**  
**Korçë:**

**Dejvi Hoxha**



**Administrator I Qendrës Sportive:**

**Luis Qirinxhi**



**KRYETAR I BASHKISË**

**SOTIRAQ FILO**

